



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT

Tiranë më, 11. 02. 2021

Lënda: Kërkesë për zhvillimin e Praktikës Profesionale të studentëve të kursit të II_të, cikli i dytë i studimeve Master Profesional, Departamenti Drejtim Agrobiznesi.

Në cilësinë e Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit duke shprehur vlerësimet e mija më të mira për punën Tuaj, si dhe duke konsideruar potencialet dhe rolin Tuaj, do t'ju lutesha që të na krijoni mundësinë për zhvillimin e Praktikës Profesionale të studentëve të Departamentit Drejtim Agrobiznesi për periudhën 22. 03. 2021 deri më datë 02. 07. 2021.

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin!



KONTRATË

Me objekt: Kryerja e Praktikës Profesionale të Studentëve të Kursit të II_të, Cikli i Dytë i Studimeve Master Profesional, Departamenti Drejtëm Agrobiznesi, të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (më tej FEA), të Universitetit Bujqësor të Tiranës (më tej UBT).

NENI 1

Institucioni//Ndermarrja _____
e përfaqesuar nga Z/Zj _____ me
detyrë _____ dhe FEA_as të UBT_së përfaqesuar nga
Z. Remzi Keco me detyrë Dekan i ketij Fakulteti, lidhin me vullnet të lirë këtë kontratë.

NENI 2

Institucioni//Ndërmarrja merr persiper:

1. Të presë, të asistojë teknkisht dhe të monitorojë për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) javore studentin/tët nga data 22.03.2021 deri me datë 02. 07. 2021 duke caktur një nga punonjesit e vet si udheheqës të tij. Udheheqësi të jetë një specialist me përvojë sa më të madhe të jetë e mundur dhe sa më afër profesionit të studentit dhe objektivave të praktikës.
2. Të krijojë sa të jetë e mundur kushte lehtësuese, si vendqëndrim të përkohshëm në një zyrë, transport brenda zonës së praktikës brenda mundësive duke shfrytëzuar udhëtimet e automjeteve të veta për qëllime pune.
3. Të vlerësojë me shkrim punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale të studentit, duke u ndalur veçanërisht në përfitimet e realizuara prej tij dhe në sugjerimet për fakultetin me qëllim përmirësimin e praktikës së studentëve të tjerë në të ardhmen. Vlerësimi i percillet zyrtarisht fakultetit në fund të praktikës.

NENI 3

Gjatë kohës së praktikës studenti zbaton orarin dhe detyrat që i cakton udheheqësi në përputhje me kërkesat e programit të praktikës dhe me përmbajtjen e kësaj kontrate.

NENI 4

Fakulteti merr përsipër:

1. Të dërgojë studentin/tët _____ në praktikë në afatin e caktuar.
2. Të mbajë lidhje dhe të komunikojë me ndërmarrjen për problemet eventuale dhe për ecurinë e praktikës.
3. Të kontrollojë herë pas here procesin e kryerjes së praktikës nga studentit me qëllim dhënie e ndihmës dhe rritjen e efektivitetit të saj.
4. Të vlerësojë praktiken e kryer nga studentët në përfundim të saj.

NENI 5

Mosmarreveshjet eventuale midis palëve do të zgjidhen me bashkëbisedim ose konsensus të dyanshëm.

U lidh me datën _____ në _____

Për Institucionin//Ndërmarrjen

Për Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit

DREJTORI

(_____)

